



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 209, DATË 16.09.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA

Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Miratur me Vendimin Nr. 209, Datë 16.09.2016

RREGULLOREE AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Neni 1
Qëllimi

1. Rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) përcakton norma të zbatueshme për mbledhjen, ushtrimin e veprimtarisë, votimin dhe zbatimin e vendimeve të këtij organi kolegjal, në përmbushje të funksioneve që i njeh ligji.

Neni 2
Baza Ligjore

1. Rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizive është një akt nënligjor që hartohet dhe miratohet në zbatim të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
2. Rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizive në përmbajtjen e saj u referohet e bën të zbatueshme edhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për organet kolegiale, Kodit të Procedurave Administrative dhe çdo akti tjetër ligjor që nuk bie ndesh me ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3
Përbërja e Autoritetit të Mediave Audiovizive

1. Autoriteti i Mediave Audiovizive është një organ kolegjal, në formën e personit juridik publik, i krijuar me ligj. Ai përbëhet nga Kryetari, zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë.
2. Mënyra e krijimit, zgjedhja e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe 5 anëtarëve dhe funksionet e Autoritetit rregullohen me ligj.

Neni 4

Ushtrimi i funksioneve dhe kompetencave

1. Funksionet dhe kompetencat e Autoritetit të Medias Audiovizive, si organ kolegjal, të parashikuara në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ushtrohen gjatë mbledhjes së tij.
2. Autoriteti i Medias Audiovizive ushtron dhe çdo funksion dhe kompetencë, që i ngarkohet nga legjislacioni tjetër në fuqi, brenda fushës së veprimtarisë së tij.
3. Gjatë ushtrimit të detyrës pranë Autoritetit të Medias Audiovizive, Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit përfitojnë pagë dhe përfitime sipas parashikimeve të ligjit nr.97/2013 dhe legjislacionit në fuqi për pagat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura të krijuara me ligj.

Neni 5

Thirrja e mbledhjeve të zakonshme të Autoritetit të Mediave Audiovizive

1. Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive vendos për datën dhe kohën e mbledhjes të organit kolegjal, duke e thirrur atë jo më rrallë se një herë në muaj.
2. Kryetari thërret mbledhjen e Autoritetit të Medias Audiovizive kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve të tij.
3. Në këtë rast, mbledhja thirret jo më vonë se 15 ditë nga data e depozitimit të kërkesës me shkrim.

Neni 6

Thirrja dhe njoftimi i mbledhjeve të jashtëzakonshme të Autoritetit të Medias Audiovizive

1. Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive, kur çmon të nevojshme, mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të organit kolegjal.
2. Në këto raste, njoftimi për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe rendi i ditës së saj u njoftohen brenda 24 orëve anëtarëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive në njërën nga mënyrat dhe mjetet e njoftimit, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 7

Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive

1. Njoftimi për mbledhjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive i dorëzohet personalisht çdo anëtar të këtij organi në formë shkresore nga ana e Sekretariatit Teknik, kundrejt nënshkrimit në regjistrin e posaçëm të protokollit.

2. Në rastet e mungesës së anëtarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ky fakt evidentohet në regjistrin e posaçëm të protokollit dhe njoftimi kryhet në mënyrat e mjetet e tjera të njoftimit të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
3. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Autoritetit të Mediave Audiovizive përmban vendin, datën dhe kohën e vendosur për mbajtjen e mbledhjes.
4. Njoftimit i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve që do të diskutohen në atë mbledhje.

Neni 8

Koha e njoftimit

1. Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive kryhet nga Sekretariati Teknik jo më vonë se 48 orë përpara datës dhe kohës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes.
2. Çdo ndryshim i vendit, kohës së vendosur apo rendit të ditës, i njoftohet çdo anëtar të Autoritetit të Mediave Audiovizive me të njëjtën formë dhe mënyrë.

Neni 9

Vendi dhe mënyra e njoftimit

1. Çdo anëtar i Autoritetit të Medias Audiovizive depoziton në formë të shkruar pranë Sekretariatit Teknik të Autoritetit adresën e vendbanimit/vendqëndrimit ose ushtrimit të profesionit, adresën elektronike, kontaktet e tij telefonike dhe mënyrën e njoftimit, të cilat ai zgjedh si të përshtatshme për të marrë njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve.

Neni 10

Thirrja e mbledhjes në kundërshtim me rregullin

1. Mbledhja e Autoritetit të Mediave Audiovizive është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 11

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës i mbledhjes së Autoritetit të Mediave Audiovizive vendoset nga Kryetari.
2. Në rendin e ditës përfshihen çështje dhe vendimmarrje të cilat, në zbatim të ligjit, janë pjesë e funksioneve dhe kompetencave të Autoritetit të Medias Audiovizive.
3. Të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e çështjeve në rendin e ditës së mbledhjes të Autoritetit të Medias Audiovizive e ka secili prej anëtarëve të Autoritetit.

4. Në këtë rast kërkesa paraqitet me shkrim dhe depozitohet brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për thirrjen e mbledhje ose në çdo kohë në mungesë të njoftimit për mbledhjen e radhës.

5. Çështja përfshihet në rendin e ditës kur kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Autoritetit.

6. Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizive së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes, nga ana e Sekretariatit Teknik të Autoritetit.

Neni 12

Drejtimi i mbledhjes

1. Kryetari i Autoritetit të Medias Audiovizive, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

2. Në rastet kur ekzistojnë shkaqe të përligjura, të tilla që nuk mundësojnë vazhdimin normal të mbledhjes, Kryetari i Autoritetit të Medias Audiovizive mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen e organit para kohe duke pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes arsyet përkatëse.

Neni 13

Zëvendësimi i përkohshëm në drejtimin e mbledhjes

1. Në rastet kur vendi i Kryetarit është vakant ose Kryetari është në mungesë për shkaqe objektive të njoftuara prej tij dhe është hartuar një akt administrativ delegimi, drejtimin e mbledhjes e kryen Zëvendëskryetari.

2. Në rastin e delegimit të kompetencave nëpërmjet aktit administrativ, akti botohet në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve publike.

Neni 14

Mbledhjet e hapura

1. Mbledhjet e Autoritetit të Medias Audiovizive, si rregull, nuk zhvillohen të hapura, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

2. Kur mbledhjet zhvillohen të hapura, rregullat për formën dhe mënyrat e njoftimit të parashikuara në këtë rregullore, zbatohen dhe për subjektet e interesuara që thirren për të marrë pjesë.

Neni 15

Kuorumi për vlefshmërinë e mbledhjes

1. Mbledhja e Autoritetit të Medias Audiovizive është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pakë se 4 anëtarë.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm jo më pakë se 4 anëtarë, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës. Në qoftë se edhe në këtë rast, në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica absolute e anëtarëve, kryetari vendos shtyrjen e mbledhjes për një datë tjetër.

Neni 16

Shqyrtimi i çështjeve të rendit të ditës

- 1.Në mbledhjen e Autoritetit të Medias Audiovizive, çështjet e rendit të ditës shqyrtohen sipas renditjes së pasqyruar në materialet bashkëlidhur njoftimit, që u janë shpërndarë anëtarëve të organit.
- 2.Me propozimin e Kryetarit ose njërit prej anëtarëve të Autoritetit, dhe me miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm, një çështje mund të shqyrtohet edhe jashtë renditjes që ajo ka në rendin e ditës.

Neni 17

Dokumentacioni shoqërues

- 1.Çdo çështje që është pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Autoritetit të Medias Audiovizive, shoqërohet me dokumentacionin shpjegues përkatës, të hartuar nga ana e administratës së Autoritetit, Këshillit të Ankesave ose subjekti propozues.
- 2.Në çdo rast, kur kërkohet vendimmarrja e Autoritetit të Medias Audiovizive, në përmbushje të funksioneve që i njeh ligji, projekt-vendimi i hartuar, shoqërohet me relacion shpjegues të nënshkruar nga strukturat përgjegjëse të administratës së AMA, Këshillit të Ankesave ose subjektit propozues. Në rast të kundërt, projekt-vendimi nuk merret në shqyrtim.
- 3.Sekretari Teknik i Autoritetit të Medias Audiovizive koordinon punën me strukturat përgjegjëse të administratës dhe Këshillit të Ankesave për përgatitjen e projektvendimeve dhe dokumentacionit shoqërues sipas standardeve dhe formatit të miratuar.

Neni 18

Mënyra e shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës

- 1.Nën drejtimin e Kryetarit të Autoritetit të Medias Audiovizive, sipas renditjes së çështjeve në rendin e ditës, organi i shqyrton ato në praninë e përfaqësuesve të administratës përgjegjëse të Autoritetit të Medias Audiovizive dhe sipas rastit, të Këshillit të Ankesave.
- 2.Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit të Medias Audiovizive gjatë shqyrtimit të çështjeve kanë të drejtë të diskutojnë, të drejtojnë pyetje, të kërkojnë materiale apo sqarime nga ana e përfaqësuesve të administratës të Autoritetit dhe Këshillit të Ankesave në lidhje me tematikat konkrete.

Neni 19

Të drejtat e subjekteve të interesuara në shqyrtimin e çështjeve

- 1.Gjatë shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, kur ligji e parashikon pjesëmarrjen e tyre, Autoriteti i Medias Audiovizive u garanton subjekteve të interesuara, të gjitha të drejtat që parashikohen në ligjin nr.97/2013 dhe siguron zbatimin e parimit të procesit të rregullt, duke u

kujdesur për plotësimin e kërkesave dhe kriterëve që parashikon Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 20 **Votimi i detyrueshëm**

1.Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit të Medias Audiovizive, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave, nuk mund të abstenojnë.

Neni 21 **Zbatimi i Kodit të Sjelljes së Autoritetit të Medias Audiovizive**

1.Gjatë zhvillimit të mbledhjes, në shqyrtimin e çështjeve dhe në procesin e votimit, Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit të Medias Audiovizive iu referohen dhe zbatojnë parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Sjelljes së Autoritetit.

2.Në çdo rast dhe situatë që mund të krijohet gjatë ushtrimit të funksionit, anëtarët e Autoritetit të Medias Audiovizive duhet të deklarojnë dhe të shmangin kryerjen e detyrës në kushtet e papajtueshmërisë ligjore ose konfliktit të interesave, ose çdo rrethane tjetër të parashikuar si ndalesë në legjislacionin në fuqi, me qëllim ruajtjen e parimit të paanshmërisë dhe ligjshmërisë në veprimtarinë e Autoritetit.

Neni 22 **Mospërfshirja në votim**

1.Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit të Medias Audiovizive që janë të pranishëm në mbledhje dhe pretendojnë se janë në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative ose konfliktit të interesave apo çdo situatë të ngjashme të parashikuar në Kodin e Sjelljes së Autoritetit, për të mos u përfshirë në votim për njërën nga çështjet e rendit të ditës, e parashtrojnë këtë fakt në fillim të shqyrtimit të çështjes përkatëse, duke u pasqyruar ky fakt në procesverbalin e mbledhjes.Në këto raste, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes votohet për përjashtimin ose jo nga votimi të anëtarit përkatës të Autoritetit të Medias Audiovizive.

2.Në rastet e mospërfshirjes në votim për shkak të pengesës ligjore ose konfliktit të interesave, Kryetari, zëvendëskryetari ose anëtari përkatës i Autoritetit nuk marrin pjesë gjatë diskutimeve të çështjes përkatëse.

Neni 23 **Përjashtimi nga votimi**

1. Kur janë depozituar kërkesa nga subjekte të interesuara, për ekzistencën e pengesave ligjore ose konfliktit të interesave të anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizive në shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës, Kryetari i Autoritetit të Medias Audiovizive i parashtron ato, së bashku me provat që i bashkëngjiten kërkesës për përjashtim.
2. Në këto raste, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes votohet për përjashtimin ose jo nga votimi të anëtarit përkatës të Autoritetit të Medias Audiovizive.
3. Anëtari i Autoritetit të Medias Audiovizive për të cilin kërkohet përjashtimi nga votimi, nuk merr pjesë në votimin e kërkesës.
4. Në rastet e përjashtimit nga votimi për shkak të pengesës ligjore, Kryetari, zëvendëskryetari ose anëtari përkatës i Autoritetit nuk marrin pjesë gjatë diskutimeve të çështjes.

Neni 24

Forma e votimit

1. Autoriteti i Medias Audiovizive i merr vendimet me votim të hapur.
2. Në rastet e votimit për çështje që lidhen me anëtarë të tij ose individë vendimet merren me votim të fshehtë.
3. Kryetari i Autoritetit të Medias Audiovizive voton i fundit.

Neni 25

Vlefshmëria e vendimeve

1. Autoriteti i Medias Audiovizive, i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet shumicë e cilësuar.
2. Vendimet lidhur me çështje që kërkojnë mendim institucional të autoritetit, të cilat Kryetari duhet ti dërgojë për mendim e diskutim anëtarëve të AMA, merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

Neni 26

Barazia e votave

1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e kryetarit është vendimtare.
2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi shtyhet për mbledhjen tjetër.
3. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër ka përsëri një barazi votash, kryhet votim i hapur, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 22 të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Sekretariati teknik i Autoritetit të Mediave Audiovizive

1. Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në funksion të mirëorganizimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjes së organit kolegjal, ngrihet dhe funksionon Sekretariati Teknik, i drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy nëpunës të administratës të caktuar me urdhër prej tij.
2. Sekretariati Teknik është përgjegjës për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji dhe kjo rregullore për mbledhjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, përgatitjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit, mbajtjen e procesverbalit, zbardhjen, publikimin dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
3. Sekretariati Teknik për ushtrimin e detyrës në funksion të mbledhjes së Autoritetit të Medias Audiovizive merr shpërblim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Procesverbali i mbledhjes

1. Sekretari Teknik i Autoritetit të Medias Audiovizive është përgjegjës dhe merr masat e nevojshme për regjistrimin në mënyrë të plotë audio dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjes së Autoritetit.
2. Në procesverbalin e mbledhjes pasqyrohet, data, koha dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet që janë diskutuar, diskutimet e pjesëmarrësve, propozimet e bëra, vendimet e marra, forma, rezultati dhe mënyra e votimit nga çdo anëtar.
3. Çdo anëtar i Autoritetit të Medias Audiovizive, mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti se ai ka votuar kundër vendimit të marrë, si dhe arsyet e votimit kundër.
4. Procesverbali i mbledhjes dhe vendimet e marra duhet të zbardhen brenda 7 ditëve nga përfundimi i mbledhjes.
5. Procesverbali mbahet nga anëtari i Sekretariatit Teknik i ngarkuar me këtë detyrë dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku, nga Kryetari i Autoritetit të Medias Audiovizive dhe anëtari i Sekretariatit Teknik, i ngarkuar për mbajtjen e tij.
6. Çdo anëtar i Autoritetit të Medias Audiovizive ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë pretendimet e tij, që parashtrihen në mbledhjen pasardhëse.
7. Vendimet e Autoritetit të Medias Audiovizive, së bashku me regjistrimet e plota audio dhe procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve depozitohen pranë këtij Autoriteti.
8. Sekretariati Teknik i Autoritetit të Medias Audiovizive merr masat e duhura për katalogimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhjeve që depozitohen pranë Autoritetit.

Neni 29

Vendimi i Autoritetit të Medias Audiovizive

1. Në përfundim të shqyrtimit të çdo çështjeje të rendit të ditës, në rastet kur në përmbushje të funksioneve të dhëna me ligj, kërkohet vendimmarrje e Autoritetit të Medias Audiovizive, në përputhje me formën dhe mënyrën e votimit, Autoriteti shprehet me vendim.

Neni 30

Përmbajtja dhe hyrja në fuqi e vendimit të Autoritetit të Medias Audiovizive

1. Vendimi i Autoritetit të Medias Audiovizive përbëhet nga: a) pjesa hyrëse, që përmban: i) emrin e Autoritetit që nxjerr vendimin; ii) palët të cilave u drejtohet vendimi; iii) datën e miratimit; iv) bazën ligjore; b) pjesën arsyetuese; c) dispozitivin që tregon: i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur; ii) kohën e hyrjes në fuqi të vendimit; iii) të drejtën e ankimit (në rastet kur parashikohet në ligj), përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.
2. Vendimi përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të Anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizive dhe vulën e Autoritetit.
3. Vendimet mbi aktet nënligjore normative të hartuar nga AMA kur parashikohen në ligjin nr. 97/2013 hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tyre dhe botohen në Fletoren Zyrtare.
4. Vendimet jonormative të Autoritetit të Medias Audiovizive hyjnë në fuqi menjëherë.

Neni 31

Zbatimi i vendimeve

1. Vendimet e Autoritetit të Medias Audiovizive, të nxjerra në zbatim të funksioneve ligjore zbatohen sipas rastit, nga ana e administratës së Autoritetit ose organet e tjera përgjegjëse ligjzbatuese, si dhe subjektet të cilave ju drejtohen.

Neni 32

Parashikime të fundit

1. Çdo akt nënligjor i miratuar nga Autoriteti i Medias Audiovizive që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

Neni 33

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.